



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-014
Prishtinë, më 9 mars 2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 MARS 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Aida Dërguti, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 shkurt 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 shkurt 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 shkurt 2015.

* * *

Pastaj, kryetari i njoftoi të pranishmit se Qeveria e Republikës së Kosovës i ka proceduar në Kuvend projekt-amendamentet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me themelimin e Gjykatës Speciale. Ai tha se këto projekt-amendamente në bazë të neneve 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës do t'i dërgohen Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse projekt-amendamentet e propozuara i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 12 mars 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015,
5. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës nga radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
6. Zgjedhja e dy (2) e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kjo pikë u shty për shqyrtim për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

2. Kërkesa e deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës

Për pikën e lartshënuar të rendit të ditës diskutuan: Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Sabri Hamiti dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Administratë Publikë, Qeverisje Lokale dhe Media, që ta shqyrtojë kërkesën e deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para se i njëjti të procedohet në seancë plenare.

3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014

Për raportin e lartshënuar, diskutoi Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

Kryesia më pas diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për rishikimin e vendimit të Kuvendit për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e Qendrës Administrativo-Protokollare “Gërmia” dhe nxori këtë:

Përfundim

Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për rishikimin e vendimit të Kuvendit për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e Qendrës Administrativo-Protokollare “Gërmia”, nr. 02-V-229-1/06, datë 17 korrik 2006, shtyhet për ndonjëherë nga mbledhjet e radhës të Kryesisë.

Kryesia diskutoi gjithashtu lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lirimin e hapësirave në ndërtesën e Kuvendit nga agjencitë e pavarura dhe nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet sekretari i përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës që të konsultohet me Ministrinë e Administratës Publike për gjetjen e hapësirave-zyrave për t'i vendosur agjencitë e pavarura, të cilat janë të vendosura në hapësirat e ndërtesës së Kuvendit.

4. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në seminarin parlamentar të Parlamentit Evropian, në Bruksel

Për kërkesën e lartshënuar, si dhe për pjesëmarrjen e delegacioneve të Kuvendit në vizita zyrtare jashtë vendit, diskutuan: Aida Dërguti, Myfera Shinik dhe Valdete Bajrami, diskutimet e të cilave janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, e shtyu vendimmarrjen për mbledhjen e radhës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Luginën e Preshevës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në këtë përbërje: Nait Hasani, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Lule Ymeri, në Luginën e Preshevës, prej datës 9-10 mars 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

6. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për anëtarët e Komisionit për Edukim, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Shqipërisë, që do ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, e shtyu vendimmarrjen për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

7. Njoftimi për dorëheqjen e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për dorëheqjen e z. Glauk Konjufca nga pozita e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilin e falënderoi për bashkëpunim e deritanishëm.

8. Njoftimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes " Vetëvendosje " për zëvendësimin e kryetarit të këtij grupi parlamentar

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" për kryetar të këtij e ka caktuar deputetin Glauk Konjufca, në vend të deputetit Visar Ymeri.

9. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për vizitën zyrtare të realizuar në Turqi

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të realizuar në Turqi, prej 5-6 shkurt 2015.

Të ndryshme

Nënkryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca, i shtroi shqetësimet e kryetares së Komisionit për Legjislacion, znj. Albulena Haxhiu, lidhur me caktimin e deputetes Xhevahire Izmaku kryetare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2015, me arsyetimin se ajo në njëërën nga seancat e mëparshme është zgjedhur gjithashtu kryetare e Komisionit ad hoc për Media.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale